



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 32/4 Prot.

Tiranë, më 06.11 .2024

VENDIM

Nr. 41 dt. 06.11 .2024

PËR

**HAPJEN E THIRRJES PËR VETËKANDIDIM PËR ANËTARIN STUDENT TË
KOMISIONIT TË KËRKIMIT, PROJEKTEVE DHE BOTIMEVE SHKENCORE**

Në zbatim të nenit 38 pika 1 (gërma i), neni 46 pika 3 dhe 6 të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr.57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e Statusit të Veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, neni 20 (gërma nj) si dhe neni 26 të Statutit të UST-së, neni 4 të Rregullores për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Përhershëm, në Nivel Institucioni, të Kërkimit, Projekteve dhe Botimeve Shkencore, neni 21, 22, 23 të Rregullores për Organizimin e Zgjedhjeve për Autoritetet dhe Organet Drejtuese në UST, Senati Akademik në mbledhjen e datës **06/11/2024**,

VENDOSI

1. Hapjen e thirrjes për vetëkandidim për anëtar student të Komisionit të Kërkimit, Projekteve dhe Botimeve Shkencore.
2. Regjistrimi i kandidatëve të kryhet pranë Këshillit Studentor të UST-së për **7 (shtatë)** ditë pune, nga data **07/11/2024** deri më **15/11/2024**.
3. Kandidatët e interesuar, në momentin e aplikimit duhet të cilësojnë qartë emrin e komisionit ku vetëkandidojnë.
4. Sekretari i Senatit Akademik të përpilojë “Njoftim” për të gjithë të interesuarit me të dhënat e sakta për kriteret, mënyrën, vendin dhe periudhën kohore të aplikimit.
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi drejtuesit e njëjësive kryesore si dhe Sekretari i Senatit Akademik.
6. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof.Dr. Agron KASA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 3214/12 Prot.

Tiranë, më 06.11.2024

Lënda: Njoftim mbi vetëkandidimin për anëtarin student të Komisionit të Kërkimit, Projekteve dhe Botimeve Shkencore

Në zbatim të nenit 38 pika 1 (gërma), neni 46 pika 3 dhe 6 të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr.57 datë 29.01.2023 “Për dhënien e Statusit të Veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, neni 20 (gërma nj) si dhe neni 26 të Statutit të UST-së, neni 4 të Rregullores për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Përbashkët, në Nivel Institucioni, të Kërkimit, Projekteve dhe Botimeve Shkencore, në pikën 17/1 të nenit 22, 23 të Rregullores për Organizimin e Zgjedhjeve për Autoritetet dhe Organet Drejtuese në UST.

Ftoheni të vetëkandidoheni për të qënë anëtar të këtij komisioni, nëse plotësoni kriteret e përcatuara në pikën 17/1 të nenit 22 pika 2 të Rregullores për Organizimin e Zgjedhjeve për Autoritet dhe Organet Drejtuese në UST. Regjistrimin mund ta bëni pranë Keshillit Studentor UST-së, brenda datë 15/11/2024 orës 15:30.

Mbetemi në pritje të vetëkandidimeve tuaja, në mënyre që në mbledhje e ardhshme të Senatit Akademik, të përzgjidhet anëtarin student, pjesë përbërëse e Komisionit të Kërkimit, Projekteve dhe Botimeve Shkencore në Universitetin e Sporteve të Tiranës.

Faleminderit për mirëkuptimin!

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof.Dr.Agron KASA

